

**AKT THEMELIMI  
SHOQERIA "APIAL-LAB" SH.P.K.**



Sot, më date 02.02.2022 ne te nenshkruarit:

Z.Marin Balla, atesia Ilir, i datelindjes 23.12.1995, lindur dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr. J51223043F

Z.Amarildo Dervishi, atesia Fatmir, i datelindjes 07.03.1982, lindur ne Berat, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr.I20307192C

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "APIAL- LAB" SH.P.K. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është "APIAL- LAB" SH.P.K.

**Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga e Kavajes, pasuria me nr 3/10, 3/12 e ndodhur ne ZK8250 me sip 54.6+39.5 m2.

**Neni 3**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e papercaktuar. Por kjo shoqeri mund te shperbehet edhe para mbarimit te ketij afati sipas rasteve te parashikuara ne statutin e kesaj shoqerie.

**Neni 4**

**Objekti i Shoqërisë është si vijon:**

Laborator mjekesor, distribucion farmaceutik, Import-eksport, prodhim – perpunim-konfeksionim te artikujve farmaceutik dhe nenprodukteve te gjakut, produkteve spitalore, kozmetike, te bimeve medicinale te lendeve te para per prodhime farmaceutike dhe kozmetike, barnave dentare dhe veterinare, paisjeve mjeksore, materialeve dentare dhe aksesore te tyre. Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve farmaceutik, spitalor, kozmetik, te bimeve medicinale, lendeve te para per prodhime farmaceutike dhe kozmetike, paisjeve mjeksore, materialeve dentare dhe aksesoreve te tyre. Import – eksport, blerje – shitje te materialeve te ndryshme industrial per qellime ndertimi dhe kontraktimi per punime te vecanta ndertuese per qellime te aktivitetit te shoqerise.

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise "APIAL- LAB" sh.p.k do te jete 100.000 leke i ndarë në 2 kuota si më poshtë vijon:

1. **Marin Balla** zotëron 1 kuota, me vlerë 50.000 lekë që përbën 50% të kuotave,
2. **Amarildo Dervishi** zotëron 1 kuota, me vlerë 50.000 lekë që përbën 50% të kuotave

**Neni 6**  
**Kontributet**

**Z.Marin Balla**, do te zoteroje 1 kuote, me vlere 50 % te kapitali themeltar, **Z.Amarildo Dervishi** do te zoteroje 1 kuote, me vlere 50 % te kapitali themeltar. Ortaku mund te vendose te rrisi kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Ortakeve. Detyrimi i ortakut kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje pergjegjesi tjetër për detyrime të tjera të Shoqerise.

**Neni 7**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vetem te drejttat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratori

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve si dhe te Administratorit te Shoqerise jane te parashikuara ne statutin e Shoqerise.

**Neni 8**


Shoqeria administrohet nga Administratori, emeruar apo revokuar nga Asambleja e Zakonshme.

1. Administratori i shoqerise do te jete **Z.Amarildo Dervishi me nje afat 5 vjecar**

Administratori shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve.

**Neni 9**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te



tretet, e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratori i Shoqerise.

#### **Neni 10**

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj Shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **Neni 11**

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

#### **Neni 12**

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve e qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

#### **Neni 13**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

#### **Neni 14**


Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Persa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregetarit dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Autorizohet Znj.Jonida Xhoxhi identifikuar me leternjoftim nr.I86209069J te ndermarre te gjitha veprimet per regjistrimin e saj ne QKB.

### **ORTAKET THEMELUES**

Marin Balla



Amarildo Dervishi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ANILA Q. KAÇUPI



DATE 02/02/2022  
NR REP 1951

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 02.02.2022, para meje Notere ANILA Q. KAÇUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Marin Balla, atësia Ilir, amësia Alketa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Myslym Shyri 15/63; Nd. P. 5; H. 4; Ap. 42; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 23/12/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034420748 dhe nr. personal J51223043F, .

NËNSHKRUES/IT:

Amarildo Dervishi, atësia Fatmir, amësia Hurma, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Kodra E Diellit; Nd. 36/1; Farkë; Selitë; 1045; Tiranë, lindur më 07/03/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036517799 dhe nr. personal I20307192C, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt Themelimi Shoqeria "APIAL- LAB" SH.P.K", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

ANILA Q. KAÇUPI

*Anila Q. Kaçupi*